



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

**RAPORT I PËRFORMANCËS SE DEPARTAMENTIT SHËNDETËSOR
TË BURGJEVE PËR VITIN 2024 DHE PLANI I PUNËS DHE
PERFORMANCËS PËR VITIN 2025**

Prishtinë, Dhjetor 2023

Contents

VIZIONI	3
Prezantim i shkurtër i funksionimit dhe organizmit të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve.....	3
PERFORMANCA.....	7
Objektivat e punës së DShB për vitin 2024.....	7
Realizimi i performancës së DShB për vitin 2024.....	8
Shpenzimi i buxhetit të DShB.....	9
Shtojcat:.....	10

VIZIONI

Trajtimi ekuivalent shëndetësor i të burgosurve sikurse edhe qytetarët e tjerë, të vendit, përmes harmonizimit dhe integritit të shërbimeve shëndetësore sipas Rregullave Evropiane të Burgjeve, Rekomandimeve të KPT të KE dhe duke respektuar specifikat e sigurisë dhe ligjet e vendit në fuqi

Prezantim i shkurtër i funksionimit dhe organizmit të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve

Fushëveprimi

1. Shërbimi i kujdesit shëndetësor në burgjet e Republikës së Kosovës organizohet dhe funksionon si pjesë integrale e sistemit shëndetësor të vendit.
2. Shërbimi shëndetësor që funksionon në burgje të cilat janë nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të specifikave organizohet dhe mbikëqyret nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DSHB) në Ministrinë e Shëndetësisë.

Përkufizimi

1. Shërbimi shëndetësor i burgjeve të Republikës së Kosovës – nënkupton shërbim profesional autonom, që në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse kujdeset për shëndetin e qytetarëve dhe banorëve të vendosur në institucionet korrektuese.
2. Departamenti shëndetësor i burgjeve – nënkupton DSHB departamentin profesional të Ministrisë së Shëndetësisë që menaxhon dhe monitoron funksionimin e shërbimeve shëndetësore përmes njësive shëndetësore në institucionet shëndetësore të cilat janë të vendosura në burgje e të cilat janë pronë e Ministrisë së Drejtësisë.
3. NjShB – nënkupton Njësinë Shëndetësore të Burgjeve e cila është forma specifike dhe organizative shëndetësore e vendosur në burgun përkatës dhe përmbledh të gjitha aktivitetet shëndetësore që kryhen në atë burg.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit shëndetësor të burgjeve janë:

1. Monitorimi dhe menaxhimi i punës së institucioneve shëndetësore në burgje (8 ambulancave, 2 stacionareve shëndetësore, 1 institucioni për kujdes shëndetësor për personat me nevoja të veçanta dhe 1 institucioni shëndetësor për kujdesin e nënës dhe fëmijës);
2. Aplikimin e planit të veprimit nga strategjia sektoriale e MSH-se për shëndetësinë në burgje lidhur me funksionimin e këtij shërbimi në harmoni me rregullat e sigurisë së burgjeve;
3. Bashkëpunimin e ngushtë me Organin Qendror të Administratës Shtetërore /SHKK/MD dhe me drejtoret e burgjeve, të cilat janë pjesë e Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të ofrimit të kujdesit shëndetësor të njëjte si për qytetarët e lirë si dhe bashkëpunimin me gjykatat dhe prokurorit për trajtimin, ekspertizën dhe raportimin shëndetësor dhe psikiatrik për persona të caktuar sipas kërkesës;
4. Aplikimin e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në aspektin shëndetësor;

5. Mbikëqyrjen dhe raportimin e rregullt të kushteve higjieniko-sanitare, ushqimit dhe ujit në burgje si dhe marrjen e masave të vazhdueshme për parandalimin e epidemive dhe marrjen e masave kundër epidemike në rast nevojë;
6. Dhënien e këshillave profesionale për rastet vështirë të menaxhueshme dhe rasteve që kërkojnë trajtim multidisiplinar dhe ndër sektorial;
7. Bashkëpunimin me të gjitha institucionet shëndetësore të vendit duke filluar nga ato të shëndetit primar, sekondar, terciar si dhe menaxhimin e dhomave të sigurta në institucione shëndetësore publike dhe menaxhimin e terminëve për trajtim të burgosurve në institucione shëndetësore publike;
8. Mbështetje në menaxhimin e situatave të komplikuar në burgje të cilat lidhen me shëndetin si grevat e urisë, tentim vetëvrasjet, dhunën në burgje, vdekjet në burgje etj.
9. Funksionimi i këtij Departamenti realizohet përmes Njësive Shëndetësore të vendosura në secilin burg (10).
10. Aktivitetet nga përgjegjësia e Departamentit menaxhohen në bashkëpunim me koordinatoret përgjegjës për çështje specifike.
11. Udhëheqësi i Departamentit shëndetësor të burgjeve raporton tek Ministri i Shëndetësisë.
12. Departamenti Shëndetësor i burgjeve menaxhon njësit shëndetësore të burgjeve sipas organogramit të MSh.

DSHB ka katër (4) koordinator:

1. Koordinatori për shërbime shëndetësore në burgje,
2. Koordinatori për shëndet mendorë në burgje,
3. Koordinatori për shërbime farmaceutike në burgje,
4. Koordinatori për te dhëna, termine dhe koordinim me SHSKUK.

Njësitë shëndetësore të burgjeve -ne tekstin e më poshtëm NjShB- janë forma të organizmit shëndetësore në secilin burg sipas specifikave të tij. Ekzistojnë dhjetë Njësi Shëndetësore të Burgjeve të ndara sipas lokacionit:

1. NjShB në QK të Dubravës,
2. NjShB në QK të Lypjanit,
3. NjShB në QP të Lypjanit,
4. NjShB në QK të Smrekovicës,
5. NjShB në QP të Prishtinës,
6. NjShB në QP të Pejës,
7. NjShB në QP të Prizrenit,
8. NjShB në QP të Mitrovicës,
9. NjShB në QP të Gjilanit,
10. NjSHB në BSL në Gerdac.

Institucionet Shëndetësore të burgjeve janë format specifike të organizimit të institucioneve shëndetësore në kuadër të NjShB të cilat licencohen nga MSh.

Llojet e institucioneve shëndetësore të burgjeve janë:

1. Ambulanca e burgut;
2. Stacionari i burgut;
3. Institucioni shëndetësor për trajtimin e personave me nevoja të veçanta;
4. Institucioni shëndetësor për kujdesin e nënës dhe fëmijës.

Funksionimi i DShB

1. Departamenti shëndetësor i burgjeve është i vendosur në objektin e Ministrisë së Shëndetësisë në Prishtinë.
2. Ministri i Shëndetësisë menaxhon drejtpërdrejt Departamentin Shëndetësor të Burgjeve në funksion të garantimit të antonimisë profesionale në bashkëpunim me MD dhe ShKK.
3. Departamenti Shëndetësor i Burgjeve udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit.
4. Drejtori i DSHB ka përgjegjësin të funksionimit të shërbimeve shëndetësore në burgje dhe mbikëqyrjen si dhe lidhshmërinë në mes të dy ministrive duke ofruar shërbime profesionale shëndetësore në burgje të nivelit të njëjtë me sistemin shëndetësor publik.
5. DShB ka (4) katër koordinator për fushat e veta të cilët i përgjigjën Drejtorit të DShB.
6. Te gjitha procedurat administrative, të personelit, të financave, të prokurimit dhe shërbimeve të tjera, kryhen sipas proceduarve të MSh, nga njësitë organizative përkatës përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë.
7. Sekretari i i Përgjithshëm i MSh garanton dhe mundëson bashkëpunimin me njësitë e tjera të MSh në funksion të integritetit të plotë të DShB në kuadër të sistemit shëndetësor të vendit.
8. Prioritetet, plani strategjik dhe ai i punës, kujdesi shëndetësor për të burgosurit janë autonome dhe të garantuara të cilat nuk mund të ndryshohen pa kërkesën e Drejtorit të DShB dhe pa aprovimin e Ministrit të Shëndetësisë në asnjë situatë në funksion të mbrojtjes së ofrimit të kujdesit shëndetësor adekuat, autonom profesional, human dhe të nivelit të njëjtë me qytetaret e tjerë.
9. Drejtori i DSHB ka të drejte të kërkojë nga Ministri i Shëndetësisë për ndryshime të planit, buxhetit, strategjisë së punës në harmoni me ndryshimet dhe nevojat eventuale shëndetësore dhe menaxhuese në situata të caktuar të pa parashikueshme si rezultat i ndonjë ndryshimi jashtë planit, paraqitjes së çfarëdo forme të pa planifikuara (protestë, grevë, rebelim, epidemi, sulm me dëme shëndetësore, ndërrim të destinacionit të burgut, hapje e burgut të ri etj).

Funksionimi i NjShB

1. Njësia Shëndetësore e burgut është forma specifike dhe organizative shëndetësore e cila është e vendosur në burgun përkatës dhe përmbledh të gjitha aktivitete shëndetësore që kryhen në atë burg.
2. NjShB menaxhohet nga Udhëheqësi i njësive shëndetësore të burgut.
3. Udhëheqësit e NjShB i raportojnë Drejtorit të DShB.
4. Udhëheqësi i NjShB është autoriteti menaxhues i të gjitha aktiviteteve shëndetësore dhe personelit shëndetësor të asaj njësie.
5. Udhëheqësi i NjShB është menaxher i plotë i personelit të asaj njësie vijueshmërinë, orarin, vlerësimin, propozimin e masave dhe aktivitete të tjera të përcaktuara me rregullore të brendshme.
6. Udhëheqësi i NjShB mban përgjegjësinë dhe raporton për gjendjen shëndetësore në mënyrë rutine, periodike dhe sipas nevojës dhe sipas kërkesës nga personat e autorizuar. Për këto raporte ai njofton çdo herë Drejtorin e DShB dhe Drejtorin e burgut.
7. Vetëm kërkesat jashtë rutine dhe kërkesa jashtë autorizimit të tij me përshkrim të vendit të punës duhet të aprovohen paraprakisht nga Drejtori i DShB.
8. Udhëheqësi i NjShB jep raporte shëndetësore për zyrtaret kompetent me kërkesë drejtuar atij ose me kërkesë drejtuar drejtorit të burgut ose me kërkesë të Drejtorit të DShB.
9. Te gjitha shkresat që dalin nga burgu, lidhur me të burgosurit, nga ana e stafit mjekësor, i kopjohen Drejtorit të DShB dhe Drejtorit të Burgut në rast nevojë.
10. Të shkresat të cilat nuk janë në kompetencë të NjShB dërgohen përmes drejtorit të DShB.

Funksionimi i IShB

Institucionet shëndetësore organizohen sipas specifikave të paracaktuara me ligj dhe janë të vendosura në burgje.

IShB janë 4 lloje sipas ligjit për shëndetësi të cilat duhet të funksionojnë sipas protokolleve dhe standardeve të përcaktuara.

IShB janë pjesë integrale e NjShB dhe menaxhohen nga Udhëheqësi i NjShB.

Të gjitha rregullat e funksionimit që vlejnë për NjShB, vlejnë edhe për IShB.

Stafi i DShB

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve gjatë vitit 2022 ka pasur 125 punëtor shëndetësor të rregullt, të licencuar nga MSh si dhe 25 konsultanta, specialistë, të lëmive të ndryshme.

Gjatë vitit 2023 do të ketë 140 profesionist shëndetësor, bazuar në ligjin për buxhetin.

Në të gjitha NjShB-të ka shërbim mjekësor 24 orësh.

Secila NjShB ka mjek me normë të plotë, shërbim infermierie 24 orësh, shërbim psikologjik me normë të plotë, shërbim psikiatrik konsultativ, shërbim stomatologjik të rregullt, laboratorik, specialitike sipas nevojës, ndërsa në stacionarin e burgut të Dubravës shërbim mjekësor 24 orësh.

Ekzistojnë hapësirat dhe pajisjet e nevojshme në të gjitha institucionet për trajtime shëndetësore të nivelit parësor dhe dytësor. Për shërbimet shëndetësore që nuk mund të kryhen në burgje, rastet referohen për institucione publike dhe private, varësisht nga nevoja.

Shërbimet shëndetësore në burgje janë ekuivalente me ato përkatëse në vend, cilësia e së cilave mbikëqyren nga inspektoratet përkatëse, KMDLNJ, MKKPT i IAP, QKRMT, KPT të KE, etj.

PERFORMANCA

Objektivat e punës së DShB për vitin 2024

Në kuadër të Objektivës I: **Ruajtja dhe përparimi i shëndetit**, shërbimi shëndetësor i burgjeve ka këto objektiva të veçanta dhe objektiva të përgjithshme të ndara në:

1. *Objektivat e veçanta, specifike:*

- 1.1. Ofrimi i kujdesit shëndetësor, farmaceutik, psikologjik, 24 orë, pa ndërprerë, falas, për të burgosurit brenda dhe jashtë institucioneve korrektuese sipas indikacioneve me staf adekuat, profesional dhe të licencuar, ekuivalent me qytetarët e tjerë të vendit.
- 1.2. Vazhdimi i avancimit të shërbimeve të shëndetit mendor.
- 1.3. Trajtimi i përdoruesve të drogave dhe lidhshmëria e trajtimit me sektorin publik të vendit.
- 1.4. Vazhdimi i funksionimit të shërbimeve për trajtimin e personave me nevoja të veçanta.
- 1.5. Avancimi i trajtimit të grupeve të rrezikut (përdoruesve të drogave, MSM, punëtorëve të seksit komercial dhe klientëve të tyre, etj) dhe sëmundjeve specifike (HBV&HCV, HIV/AIDS, TBC, SST dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse dhe jo ngjitëse).
- 1.6. Funksionalizmi i SISh, telemjekësisë, transportit dhe zbatimi i sigurimit shëndetësor për të burgosurit.
- 1.7. Bashkëpunimi me institucione shëndetësore, edukative, trajnuese, monitoruese dhe këshillëdhënëse vendore dhe ndërkombëtare në dobi të avancimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe avancimit të stafit profesional përmes trajnimeve dhe specializimeve.

2. *Objektivat e përgjithshme me 46 aktivitetet:*

- 2.1. Rritja e vazhdueshme e cilësisë së kujdesit shëndetësor;
- 2.2. Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe kuantitative specifike për burgje;
- 2.3. Integrimi i plotë i DShB në kuadër të mekanizmave funksional dhe profesional të MSh-së;
- 2.4. Zbatimi i dokumentacionit specifik dhe proceduarve të punës;
- 2.5. Kujdesi shëndetësor ekuivalent dhe i vazhdueshëm për të gjithë të burgosurit;
- 2.6. Kujdesi farmaceutik për të gjithë të burgosurit falas sipas LESPK dhe Ligjit për Shëndetësi në Kosovë dhe rregulloreve të AKPM-së;
- 2.7. Mbatja dhe monitorimi në nivel të lartë të kushteve higjienike sanitare në burgje;
- 2.8. Menaxhimi i mirë i stafit shëndetësor të burgjeve;
- 2.9. Monitorimi i vazhdueshëm i kujdesit shëndetësor;

Realizimi i performancës së DShB për vitin 2024

Realizimi i planit sipas indikatorëve për vitin 2024 nga 9 objektiva dhe 46 aktivitete, rezulton se 35 aktivitete përkatësisht 76.09% janë realizuar plotësisht, 8 aktivitete përkatësisht 17.39% janë realizuar pjesërisht, ndërsa 3 aktivitete përkatësisht 6.52% nuk kemi mundur ti fillojmë fare.

Nga 8 aktivitete që janë në proces, janë aktivitete afatgjate e të cilat zhvillohen në periudha afatgjata. Nga 3 aktivitete e pa filluara janë çështje të cilat nuk varen nga DShB por janë çështje ligjore dhe zbatim i tyre përfshirë buxhetin zbatimin e kontratës kolektive, rrezikshmërinë, pagat jubilarë si dhe aktivitete të tjera për të cilat është planifikuar që të shqyrtohet mundësia e zbatimit të tyre në vitet në vijim.

Këtij raporti i është bashkëlidhur edhe raporti i plotësuar sipas indikatorëve dhe aktiviteteve në veçanti.

Legjenda	1	E gjelbert	e përfunduar plotësisht	35	76.09%
	2	E kaltërt	në proces	8	17.39%
	3	E kuqe	e pa filluar	3	6.52%
			Totali	46	100.00%

- Nën mbështetjen e Këshillit të Evropës, ka vazhduar zbatimin e projektit “Përmirësimin e trajtimit për personat e privuar nga liria” me përgatitjen e PSV-ve, zbatimin e tyre në vend të punës dhe trajnimin e trajnerëve.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe vështirësi të shumta, siç janë:

1. Vonesat dhe pamundësitë në implementimin e rrezikshmërisë së stafit e cila do të kompensonte në një formë punën specifike dhe me presione si dhe rrezikun permanent.
2. Qëndrueshmëria jo stabile e stafit, kemi pasur largim në vazhdimësi të stafit mjekësor nga burgjet, si rezultat i pakënaqësisë me pagën, specializimet dhe mungesën e rrezikshmërisë, marrë parasysh specifikat e punës dhe natyrën e ballafaqimeve.
3. Mungesa edhe e dy autoambulancave për transportin e të burgosurve në nevojë.
4. Vështirësi të tjera në realizimin e detyrave si pasojë e integritit të plotë në kuadër të shërbimeve të ndryshme të MSh-së dhe shpesh herë mungesë e të kuptuarit dhe përkrahjes së specifikave të punës që ka shëndetësia në burgje.
5. Vështirësi në lidhjen e kontratave për shërbime të caktuar si dhe furnizimit të qëndrueshëm për disa çështje.
6. Ndërrimi i lokacionit me zyre i DShB, jashtë objektit të MSh-së, çka ka vështirësuar komunikimin me shërbimet administrative të MSh-së të cilat kryejnë këto shërbime për DShB.
7. Mungesë totale e veturave për shërbime të DShB dhe NjShB-ve.
8. Në funksion të transparencës së mjaftueshme, të gjitha aktiviteteve i kemi publikuar në web faqe të Ministrisë. <https://msh.rks-gov.net/Department/Index/10?type=1>

DShB ka synime që në vazhdimësi të arrijë këto qëllime:

1. Vazhdimi i ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje dhe qëndrueshmëria e saj përmes trajnimeve, monitorimeve dhe krijimit të kushteve për shërbime cilësore.
2. Vazhdimi i krijimit të kushteve adekuate të favorshme për stafin mjekësor për punën në burgje konform UA 05/2014 dhe Rekomandimeve të Këshillit të Evropës, rregullave Evropiane të

Burgjeve dhe Udhërrëfyesve të OBSH-së, përfshirë pagën e dinjitetshme, rezikshmërinë dhe beneficione të tjera në funksion të qëndrueshmërisë së stafit në burgje.

3. Zbatimi i plotë i protokolleve, procedurave, hapësirave të punës dhe pajisjeve për punë në Njësitë shëndetësore të burgjeve konform standardeve të MSh-së dhe BE-së.
4. Vazhdimi i furnizimit të qëndrueshëm në të gjitha institucionet me barëra dhe material mjekësor.
5. Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve higjienike sanitare në të gjitha institucionet korrektuese dhe kujdesi higjienik e sanitar i përhershëm përmes DDD dhe formave tjera higjienike si dhe ngritjen e njohurive mbi rëndësinë e higjienës personale në burgje.
6. Bashkëpunimi dhe trajnimi specifik i organeve monitoruese të shërbimeve shëndetësore në burgje përmes trajnimit adekuat, profilizimit dhe ndikimit në ngritjen e cilësisë së shërbimeve.
7. Rritjen e bashkëpunimit me shërbimet e tjera të MSh-së në funksion të integritetit të plotë të shërbimeve në kuadër të sistemit shëndetësor publik.
8. Adresimin e çështjeve bazike në aktet ligjore për rregullimin dhe forcimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve shëndetësore në burgje, si proces i aprovuar nga KE dhe shembull për funksionim në vendet e tjera të rajonit dhe më gjerë.

Me eliminimin e vështirësive, ne do të kemi mundësi që planin e performancës ta realizojmë me një përqindje edhe më të lartë. Këto 3 aktivitete kryesisht janë të përfshira në vështirësi në realizimin e tyre.

Sa i takon 8 aktiviteteve të cilat janë në vazhdimësi, ato aktivitete janë pjesë e vazhdueshme e aktiviteteve të cilat përcillen ndër vite.

Shpenzimi i buxhetit të DShB

- Për vitin 2024 është aprovuar buxheti prej 2,149,603.00€ (Paga dhe mëditje 1,410,903.00€; Mallra dhe shërbime 683,200.00€, Kapitale 50,000.00€, ndërsa Komunalit 5,000.00€).
- Ky buxhet nuk është i mjaftueshëm për mbulimin e të gjitha shërbimeve shëndetësore të burgjeve, veçanërisht pagat.
- Kemi përcjellë vazhdimisht ecurinë e buxhetit dhe shpenzimet.
- Vetëm kategoria e pagave dhe mëditjeve nuk është e mjaftueshme për vitin 2024 dhe po ashtu as për vitin 2025, me rreth 200,000.00€.

Nr	Kategoria	Buxheti i ndarë për vitin 2024	Shpenzuar deri me 11.12.2024	Përqindja e shpenzimit	Vërejtje
1	Kodi 726; DShB, Buxheti Total	2,149,603.00	2,097,723.43	97.59	Total buxheti i realizuar
2	NUMRI I STAFIT	140	140	100	
2	RROGA DHE PAGA	1,410,903.00	1,497,513.50	106.14	Është tejkaluar shuma e paraparë si pasojë e mos paraqitjes së shtesave për ndryshime të natës dhe kujdestari
3	MALLRA DHE SHËRBIME	683,200.00	548,599.93	80.30	Nuk është realizuar më shumë sepse nuk ka psur kontrata, të cilat tani janë nënshkruar me vonë dhe të tjera janë në proces.
4	SHPENZIME KOMUNALE	5,500.00	3,000.00	54.55	Ka pasur kursime.
5	PASURITË JO FINANCIARE - KAPITALET	50,000.00	48,610.00	97.22	Është përfunduar projekti, kemi mungesë edhe 7,000.00 euro per dy pajisje që ka kontratë për to.

Vërejtje: Ky shpenzim është paraqitur vetëm për përudhen Janar – gjysma e Dhjetorit , 2024, raporti i plotë, gjithëpërfshirës, do të bëhet pas përfundimit të vitit kalendarik.

Shtojcat:

Në shtojcë të këtij Raporti janë bashkëlidhur tabelat për:

- 1. Raporti i punës së performancës së DShB për vitin 2024, sipas indikatorëve;*
- 2. Plani i punës së performancës së DShB për vitin 2025, sipas indikatorëve;*

Gjatë Janarit do të përfundohet Raporti Final i Punës ku do të përfshihet edhe performanca.

Me respekt!